VENDIM
Nr.296, datë 22.12.2004

PËR DHËNIEN E LICENCE

PËR RADIO VENDORE PRIVATE
"LEZHA"
SUBJEKTIT: Z. GJOVALIN DUSHAJ

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radio dhe televizionin shqiptar publik e privat në republikën e Shqipërisë", rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatoreve privatë radio e televizive", të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin shtator, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit, z. Gjovalin Dushaj, me vendndodhje në qytetin e Lezhës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulimin në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj